

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**<M.A.G PARTNERS >**

Ne Tirane, me date 24.02.2021

Ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe akteve te tjera.

Ne baze te ligjit Nr. 9723, dt 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

Ne Tirane sot me daten 24.02.2021 (dy mije e njezete e nje) shtetasi: Z.GENTIAN ELEZI, i biri i ZENEL lindur me 12.12.1989 ne KUÇOVE dhe banues ne: Njesia bashkiake nr. 6 "Fabrika e qelqit" 268 Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr . BE0998777.

Vendos sa vijon:

**NENI 1**

Deklaron se me vullnet te lire, te plote, te sinqerte dhe iniciativen e lire private mbeshtetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi te cituar me siper hartoj sot Statutin e shoqerise "**M.A.G PARTNERS**" SH.P.K.

**KREU I**

THEMELIMI , EMRI ,OBJEKTI , KOHEZGJATJA ,SELIA DHE ADRESA

**Neni 1**

**Data e themelimit, Emri dheThemeluesit**

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "**M.A.G PARTNERS**" SH.P.K, Tirane eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuara ne ligj.

**Neni 2**

**Selia e shoqerise**

Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Njesia bashkiake nr. 6 "Fabrika e qelqit" 268, nr pasurie 426/108-G3. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, Shoqeria mund te cele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise, gjithashtu shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo edhe jashte tij.

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike**

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise eshte me nje afat te pa percaktuar.

### **Neni 4**

#### **Objekti i veprimtarise se shoqerise**

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj konform objektit qe do te jete:

Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim i punimeve te ndertimit si: Rikonstrukcion godinash civile, industriale dhe ekonomike, veshje fasadash, hidroizolime termoizolime. Montim dhe instalim, impianteve elektrik, impianteve hidraulik dhe termik, impianteve te avullit. Montimi dhe instalimi i linjave dhe pajisjeve ne fabrikat e industrise se rende edhe ne ate ushqimore. Punime germimi ne toke. Ndertime civile dhe industriale. Ndertim rruge, autostrada, mbikalime, impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndricuese, barrierra dhe mbrojtje rrugore, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Punime nentokesore, ura e vepra arti. Ndertim ujesjellesa, kanalizime, gazsjellesa, vajsellesa, veprakullimi e vaditje. Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Zbatime projektme dhe punime elektrike per rryma te dobeta dhe te tensionit te larte. Punime per prishjen e ndertimeve. Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre. Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues). Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri. Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. Punime topogjeodezike.

### **Neni 5**

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise ose te zvogloje kapitalin e saj sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie

## **KREU II**

### **KAPITALI I REGJISTRUAR**

**Neni 6**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 10.000 leke (Dhjete mije Leke). Formuar dhe nenshkuar nga ortaku i vetem i shoqerise i barabarte me 1 Kuota me vlere nominale 1 kuote /10.000 leke i depozituar sipas ligjit dhe perkatesisht i ndare ne pjese te Kapitalit si me poshte:

Z.GENTIAN ELEZI, i biri i ZENEL lindur me 12.12.1989 ne KUÇOVE dhe banues ne: Njesia bashkiake nr. 6 "Fabrika e qelqit" 268 Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. BE0998777 zoteron 100 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Ortaku i vetem ka te drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter te fituar ne rruge te ligjshme, Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

**Neni 7**  
**Zmadhimi i Kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te rritet ne te adhmen, nepermjet nenshkrimit dhe shlyerjes se kuotave te reja nga ortake te rinj, vetem me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve, ku do te miratohet si rritja e kapitalit ashtu edhe hyrja e ortakeve te rinj. Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimeve te ortakeve.

**Neni 8**  
**Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

**NENI 9**

Shoqeria do te kete Administrator te saj Z.GENTIAN ELEZI

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.

Administratori ka te drejte te caktoje nje apo me shume perfaqesues te tij qe te mund te kryejne deri te njejtat funksione si administratori pa asnje limit, me prokure apo me autorizim, sipas ligjit.

## **NENI 10**

ORTAKU I SHOQERISE NUK MUND TE TERHEQE PJESEN E KAPITALIT TE DERDHUR PREJ TIJ ,KJO BEHET VETEM MBASI TE NXIRET BILANCI I SHOQERISE PER FITIMIN E REALIZUAR

## **KREU III**

### **ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 11**

Per administrimin e te ardhurave te shoqerise gjate aktivitetit te saj do te caktohen specialist kontabel per kryerjen e te gjithë veprimeve financiare, per evidentimin e te ardhurave te realizuara, fitimit si dhe te detyrimeve. Ato do te evidentohen ne librat e llogarise . Ekspertet kontabel emerohen me vendim te asamblese se ortakeve.

#### **Neni 12**

Aktiviteti i shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti. Bilanci duhet te shoqerohet nga nje relacion i asamblese se ortakeve qe sqaron mbarevajtjen e administrimit ne sektore te ndryshem te aktivitetit te shoqerise duke i kushtuar nje vemendje te madhe investimeve, cmimeve dhe kostove si dhe fate te tjera te rendesishme te verejtura mbas mylljes se aktivitetit te periudhes.

#### **Neni 13**

Bilanci dhe relacioni i asamblese se ortakeve duhet te depozitohet prane selise se shoqerise 15 dite pas mbledhjes se ortakeve qe do te thirren per ta aprovuar.

#### **Neni 14**

Rastet e shperndarjes se shoqerise jane:

- Perfundimi i afatit te parashikuar per vazhdimin e saj
- Arritja e objektivit te shoqerise ose pamundesia e arritjes se tij si dhe nga raste te tjera te parashikuara ne ligj.

#### **Neni 15**

Ne rast te shperndarjes se parakohshme te shoqerise, asambleja e ortakeve nga dita qe vendoset shperberja merr funksionin dhe pergjegjesine e likujdatorit me perjashtim te rasteve kur asambjeja e ortakeve vendos ndryshe.

#### **Neni 16**

Ne rast se vendoset per likujdatore merret vendim nga asambleja e ortakeve me votim unanim.

**Neni 17**

Likujdatori brenda 6 muajve nga emerimi therret asamblene e ortakeve te cilet i paraqet raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivitet te shoqerise para fillimit te operacionit te likujdimit.

**Neni 18**

Likujdatori perfaqeson shoqerine dhe gezon te gjitha kompetencat e domosdoshme per likujdimin e aktivitet dhe pasivitet te shoqerise. Ai eshte i autorizuar te rimbursoje te gjitha kreditoret dhe tu shperndaje ortakeve mbetjet ne dispozicion.

**Neni 19**

Likujdatori ploteson raportin e kontabilitetiteti vjetor 3 mujor mbas mbylljes se vitit financiar ne baze te inventarit mbi elemente te ndryshem te aktivitet dhe pasivitet si dhe nje raport te shkruar mbi administrimin dhe gjitha operacionin e likujdimit.

**Neni 20**

Shperndarja e aktivitet qe mbetet pasi pjeset e kapitalit baze do tu rikthehen ortakeve ose ortakut te vetem do tu shperndahen ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar.

**Neni 21**

Te gjitha mosmarreshjet qe lindin midis shoqerise e te treteve apo midis ortakeve te saj n.q.s nuk zgjidhen me mirekuptim, ose ne rruge administrative, palet kane te drejte ti drejtohen per zgjidhje organeve gjyqesore.

**Neni 22**

Per cfare nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

**Neni 23**

Standarti hartohet ne 4 kopje origjinale.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE TREGTARE**

**"M.A.G PARTNERS " SH.P.K**  
**Z. GENTIAN ELEZI**

